

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-080/12

**Prishtinë,
19 shkurt 2013**

Në çështjen juridike të:

M.D.

Pala ankuese

kundër.

V. D. M.

Paraqitësi e kërkesës/Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit i AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Gjyqtarët: Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, Elka Filcheva-Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, Anëtarë, duke vendosur me ankesat kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/112/2011 (lëndët e regjistruara në AKP me numrat KPA56636, KPA56644, dhe KPA56647) i datës 22 qershor 2011, pas shqyrtimit të mbajtur me 19 shkurt 2013, morri këtë

AKTGJYKIM

- 1- Lëndët GSK-KPA-A-80/12 deri GSK-KPA-A-82/12 janë bashkuar në një lëndë të vetme nën numrin GSK-KPA-A-80/12.
- 2- Refuzohet si e pabazuar ankesa e M.D. e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/112/2011 (lëndët e regjistruara në AKP me numrat KPA56636, KPA56644 dhe KPA56647), i datës 22 qershor 2011.
- 3- Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/112/2011 (lëndët e regjistruara në AKP me numrat KPA56636, KPA56644, dhe KPA56647) i datës 22 qershor 2011 .
- 4- Obligohet pala ankuese që të paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej 80 € (tetëdhjetë euro) në Buxhetin e Kosovës, brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

Më 28 janar 2008, V.M. ka paraqitur tri kërkesa në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), ku ka kërkuar riposëdimitin e pronës që ndodhet në zonën kadastrale Zhegra të Komunës së Gjilanit në vendin e quajtur "Suka", ngastrave kadastrale nr. 121, 999 në vendin e quajtur "Jaruga golema njiva" dhe nr. 2054 në vendin e quajtur "Vrbnica". Ai ka pohuar se babai i tij D. është pronar i pronave por ai është dashur të largohet nga to për shkak të konfliktit të armatosur të vitit 1998/1999. Për të mbështetur kërkesën e tij, ai përpos tjerash ka paraqitur në AKP dokumentet e mëposhtme:

- Fletën poseduese Nr. 115 të datës 23 prill 2002, të lëshuar nga Enti Republikan për Gjeodezi të Serbisë, në emër të M. D. lidhur me tri ngastra –121,999 dhe 2054;
- Letërnjoftimin e V. M. i datës 20 shtator 2005;
- Certifikatën e lindjes të lëshuar nga Komuna e Vranjës në Republikën e Serbisë, e datës 23 janar 2008 me të cilën vërtetohet se paraqitësi i kërkesës është djali i D. Maladenović, titullarit të pronave të kërkuara;
- Çertifikata e vdekjes e lëshuar nga Komuna e Vranjës Republika e Serbisë e datës 23 janar 2008, me të cilën konstatohet se D. M., ka vdekur në Zhegër, Komuna e Gjilanit me 04 nëntor 1988, dhe
- Çertifikata e të drejtave e pronës së paluajtshme UL-70403026-00115 e datës 7 shtator 2008 e lëshuar nga Zyra Kadastrale Gjilan, me të cilën konstatohet se paluajtshmëritë e kërkuara janë të regjistruara në emër të M. D. dhe i referohet ngastrave kadastrale siç vijon edhe atë:

Numri i ankesës dhe dosjes së lëndës së AKP-së	Të dhënat lidhur me ngastrën e kërkuar
GSK-KPA-A-80/12 (KPA56636)	Ngastra Nr. 121, në vendin e quajtur “Suka”, arë e klasës së 3-të, me sipërfaqe prej 0. 30. 84 ha
GSK-KPA-A-81/12 (KPA56644)	Ngastra Nr. 999, në vendin e quajtur “Jaruga golema njiva”, arë e klasës së 2-të, me sipërfaqe prej 0. 41. 19 ha
GSK-KPA-A-82/12 (KP056647)	Ngastra Nr.2054, në vendin e quajtur “”,Vrbnica” arë e klasës së 3-të, me sipërfaqe prej 0.15.69 ha

Sekretaria Ekzekutive e AKP-ës këto dokumente i ka verifikuar pozitivisht.

AKP-ja i ka njoftuar palët potenciale të interesuara për ekzistimin e kërkesave duke vendosur lajmërimet në ngastrat që janë objekt i tre kërkesave: ngastrën kadastrale 999 dhe 2054 me 22 maj 2008 dhe për ngastrën kadastrale 121 me datë 19 maj 2008.

Me vendimin KPCC/D/A/29/2008 të datës 19 dhjetor 2008, KKPK-ja ka pranuar se kërkesat janë të bazuara duke ia pranuar paraqitësit të kërkesës pronësinë mbi pronat bujqësore të kërkuara dhe duke vendosur që t'i kthehen në ri posedim atij këto paluajshmëri nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm. Komisioni ka vlerësuar se dokumentet e paraqitura legjitimojnë paraqitësin e kërkesës si pronarë të ligjshëm.

Me urdhëresën KPCC/RES/12/2010 të datës 24 janar 2010, ka anuluar vendimin e KPCC/D/A/29 të datës 19 dhjetor 2008, sa i përket lëndëve të regjistruara në AKP me numrin KPA56636, KPA56644, dhe KPA56647, me qëllim të sigurimit të njoftimit të saktë të pronave dhe për t'i siguruar mundësinë çdo personi që ka interes juridik për të dhënë përgjigje për pronat e kërkuara sipas dispozitës së nenit 10.1 të Rregullorës së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079.

Sekretaria Ekzekutive e AKP-ës, rinjoftoj paluajshmëritë që janë objekt i kërkesave me njoftimin fizik duke vendosur lajmërimet përkatëse siç ka vepruar rëndom, por ka bërë njoftimin përmes publikimit më datë 30 korrik 2010 në gazetën nr. 6 duke e shpërndarë dhe afishuar atë në fshatin Zhegër, Zyrën Kadastrale, Kuvendin e Komunës, Gjykatën Komunale në Gjilan si dhe në Zyrën e AKP-ës Gjilan. Po kështu këto prona të paluajtshme që janë objekt i kërkesave janë njoftuar përmes publikimit në gazetën informative të AKP-ës për njoftim dhe se të njëjtat janë shpërndarë organeve përkatëse qeveritare.

Mëtutje AKP-ja ka konstatuar se nuk ka pasur uzurpim, shfrytëzim dhe kultivim të këtyre pronave dhe se asnjë palë nuk e ka kontestuar vlefshmërinë e këtyre kërkesave mbrenda afatit ligjor prej tridhjetë (30) ditësh të parashikuar me nenin 10 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079.

Me vendimin KPCC/D/A/112/2011 të datës 22 qershor 2011, KKPK-ja ka pranuar se kërkesat janë të bazuar duke ia pranuar paraqitësit të kërkesës pronësinë për pronat bujqësore të kërkuara, dhe ka vendosur që ato t'i kthehen në ri posedim paraqitësit të kërkesës nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm. Komisioni ka vlerësuar se dokumentet e paraqitura legjitimojnë paraqitësin e kërkesës si pronarë të ligjshëm.

Vendimi i është dorëzuar paraqitësit të kërkesës më 11 nëntor 2011 dhe se ai ka paraqitur përgjigje në ankesë me datë 12 shtator 2012; ndërsa M. D. ka paraqitur ankesë me datë 14 qershor 2012. Nuk ka prova që vendimi KPCK-ës i është dorëzuar paraqitësit të ankesës. Ankuesi vendimin e ankimor e kundërshton për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes thelbësore të ligjit procedural dhe material. Ai në cilësinë provës paraqet tapinë e vitit e vitit 1874 e sjellë nga Turqia. Paraqitësi i kërkesave në përgjigjen e tij në ankesë pretendon se ankuesi nuk ka marr pjesë në procedurë në afatin prej 30 ditësh pas njoftimit nga AKP për kërkesat e paraqitura, sipas nenit 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50; adaj, ai propozon që sipas nenit 13.3 Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 Gjykata Supreme t'i hedh ankesat si të palejueshme. Tapia e paraqitur e vitit 1874 si provë e vetme nuk provon asgjë për sa i përket fakteve relevante lidhur me pronësinë e kërkuar; prandaj edhe mbi këtë bazë, ai propozon që ankesa të refuzohet. Gjykata Supreme i ka bashkuar lëndët.

Arsyetim ligjor:

Bashkimi i lëndëve:

Gjykata Supreme i ka bashkuar kërkesat.

Neni 13.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079 mbi Zgjidhjen e Kërkesave lidhur me Pronën e Paluajtshme Private duke përfshirë Pronën Bujqësore dhe atë Komerciale, parashikon se Gjykata Supreme mund të vendosë për ankesat e bashkuara apo të shkrira, kur për bashkimin apo shkrirjen e kërkesave është vendosur nga Komisioni, në pajtim me nenin 11.3 (a) të kësaj Rregulloreje. Ky nen i mundëson Komisionit që të marrë në konsideratë bashkimin ose shkrirjen e kërkesave me qëllim të shqyrtimit dhe marrjes së vendimeve kur ekzistojnë çështje të përbashkëta ligjore dhe të provave.

Dispozitat e Ligjit mbi Procedurën Kontestimore të cilat janë të zbatueshme në procedurën e Kolegjit të Apelit pranë Gjykatës Supreme sipas nenit 12.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin

Nr. 03/L-079, gjithashtu të nenit 408.1, në lidhje me nenin 193 të Ligjit Nr. 03/L006 mbi Procedurën Kontestimeve, parashikojnë mundësinë e bashkimit me aktvendim së të gjitha padive nëse ky bashkim i kontribuon efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

Më tutje Gjykata Supreme e Kosovës vëren se faktet, baza ligjore dhe çështja e provave janë plotësisht të njëjta në të 3 (tri) lëndët. Vetëm parcelat, objekte të së drejtës pronësore, të cilat pretendohen në secilën kërkesë, janë të ndryshme. Ankesat bazohen në deklaratën e njëjtë sqaruese dhe në dokumentacionin e njëjtë. Meqë të gjitha elementet e lëndës janë të njëjta përveç parcelave, do të ishte më efektive nëse bashkohen ankesat dhe ato të ekzaminohen në një aktgjykim të vetëm.

Ankesat e regjistruara nën numrat GSK-KPA-A-80/12, GSK-KPA-A- 81/12 dhe GSK-KPA-A- 82/12 janë bashkuar në një lëndë të vetme të regjistruar nën numrin GSK-KPA-A-80/12.

Lidhur me pranimin e ankesës

Në bazë të konstatimeve faktike, ankesa është e pranueshme. Me urdhëresën KPCC/RES/12/2010 e datës 24 janar 2010 është anuluar vendimi KPCC/D/A/29 i datës 19 dhjetor 2008, sa i përket lëndëve të regjistruara në AKP me numrin KPA56636, KPA56644, dhe KPA56647, dhe është detyruar Sekretaria Ekzekutive bëjë rinjoftimin fizik dhe të saktë të pronave, për t'i mundësuar çdo personi që ka interes juridik për të dhënë përgjigje për pronat e kërkuara sipas nenit 10.1 të Rregullorës së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079.

Meqë, Sekretaria Ekzekutive nuk kishte bërë rinjoftimin fizik dhe të saktë të pronave që janë objekt i kërkesave, ashtu siç kërkohet në procedurën para AKP-së sipas 10.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, mund të konkludohet se pala ankuese nuk ishte njoftuar me njoftimin fizik dhe të saktë të këtyre paluajtshëmëve. Sipas kësaj dispozite ligjore, KPKK-ja ka për detyrim që, duke bërë njoftimin e plotë dhe të saktë, duke përfshirë edhe rinjoftimin fizik të pronave të kërkuara, me vendosjen e lajmërimeve në këto prona, ashtuqë të sigurohet çdo personi që ka interes ligjor mundësinë për tu përgjigjur në kërkesë.

Meqenëse Sekretaria Ekzekutive nuk ka bërë përpjekje të arsyeshme për të bërë rinjoftimin e saktë dhe të plotë fizik të paluajtshëmëve që janë objekt i kërkesës, ankuesi në kundërshtim me paragrafin 2 të këtij neni është, prandaj edhe rrjedhimisht e drejta e tij për ankesë nuk është përjashtuar.

Për meritat e aktgjykimit.

Gjykata Supreme e Kosovës pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, vendimit ankimor dhe pretendimeve ankimore gjeti se ankesat e ankuesit janë të pabazuar. Kjo ngase, sipas Certifikatës së të drejtave të pronës së paluajtshme UL-70403026-00115 e datës 7 shtator 2008, e lëshuar nga Zyra Kadastrale Gjilan konstatohet se

paluajtshmëritë e kërkuara janë të regjistruara në emër të M. D., duke ju referuar ngastrave kadastrale 121, 999 dhe 2054. Prandaj, në bazë të konstatimeve e këtilla faktike me pa mëdyshje rezulton që sipas nenit 20 të Ligjit themelor të Mardhënjeve Pronësore Juridike, përkatësisht nenit 36 të Ligjit të Pronësisë dhe të Drejtave të tjera Sendore, titullar i të drejtës së pronësisë në pronën e paluajtshme bujqësore të kërkuar është M. D.. Prandaj, vendimi i KPKK-ës me të cilin i është njohur e drejta e pronësisë dhe i janë dhënë në riposeditim paluajtshmëritë M. D. është i drejtë dhe i ligjshëm.

Pretendimet e ankuesit se vendimi ankimor është marr me vërtetim të gabuar të gjendjes faktike duke e paraqitur si provë tapinë e vitit 1874 të sjellë nga Turqia, nuk përfaqësojnë prova juridikisht të vlefshme për të vërtetuar të drejtën e pronësisë në ngastrat kontestuese sipas neneit 4 paragrafi 2 i Ligjit për Qarkullimin e Paluajtshmërisë (Gazeta Zyrtare e R.S.nr.43/81), nenit 20 të Ligjit Themelor të Marrëdhënieve Pronësore Juridike si dhe nenit 36 të Ligjit të Pronësisë dhe të Drejtave tjera Sendore. Sipas këtyre dispozitave ligjore për fitimin e pronësisë kërkohet kontrata e shitjes në formë të shkruar dhe e njëjta të legalizohet nga autoriteti kompetent siç mund të jenë gjykatat apo noteritë, gjë që për rastin konkret nuk mund të thuhet. Prandaj këto pretendime të ankuesit janë të pabazuara të papranueshme dhe rrjedhimisht në kundërshtim me këto dispozita ligjore. Po kështu, pretendimet ankimore janë në kundërshtim me faktet relevante të vlefshme të vërtetuara dhe provat e administruara në procedurën administrative të AKP-ës. Përpos kësaj, objekt i veçantë i shqyrtimit dhe vlerësimit ishte edhe ekstrakti i tapisë që i referohet vitit 1874, i lëshuar nga Agjencia Shtetërorë e Arkivit të Kosovës i datës 06 qershor 2012 por gjeti se tapia nuk është dokument juridikisht i vlefshëm për t'i vërtetuar faktet juridikisht të vlefshme lidhur me pretendimin e ankuesit që i referohet pronës së kërkuar. Nga ky Ekstrat i tapisë nuk mund të vërtetohet ekzistimi i lidhjes kauzale të shënimeve të paraqitura në atë tapi dhe pronës së kërkuar sipas Certifikatës së të drejtave e pronës së paluajtshme UL-70403026-00115 i datës 7 shtator 2008 të lëshuar nga Zyra Kadastrale Gjilan, me të cilën konstatohet se paluajtshmëritë e kërkuara janë të regjistruara në emër të M. D.. Shënimet e theksuara në ekstraktin e tapisë nuk mund të konkretizojnë përmasat dhe përkufizimet me elemente të sakta gjeometrike dhe se cilave paluajtshme iu referohet ai ekstrakt. Përpos kësaj ankuesi nuk paraqiti asnjë fakt dhe nuk propozoi asnjë provë juridikisht të vlefshme për të vërtetuar rrethanën e humbjes së këtyre paluajtshmeve, duke e vënë në dyshim vendimin ankimor.

Rrjedhimisht mbi të mësipërmen, Gjykata Supreme konkludon se, vendimi i KPKK-ës është i drejtë dhe i ligjshëm, dhe se ka dhënë shpjegime dhe sqarime të mjaftueshme për faktet vendimtare për një vendim të bazuar me ligj. Vendimi ankimor nuk është përfshi me shkelje thelbësore të ligjit material dhe procedural sipas ne12.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079.

Prandaj, refuzohet ankesa e ankuesit si e pabazuar sipas nenit 13.3 (c) Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079.

Shpenzimet e procedurës:

Në përputhje me Shtojcën III, nenin 8.4 të Urdhëresës Administrative (UA) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, palët përjashtohen prej shpenzimeve të procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Ndërkaq një përjashtim i tillë nuk parashikohet në procedurën para Kolegjit të Apelit. Rrjedhimisht, regjimi normal i shpenzimeve gjyqësore siç parashihet me Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK, 3 tetor 1987) dhe sipas UA nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi Unifikimin e Taksave Gjyqësore, zbatohet ndaj procedurës së zhvilluar para Kolegjit të Apelit.

Prandaj, shpenzimet gjyqësore si në vijim aplikohen në procedurën e tanishme të ankesës:

- Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (neni 10.11 i UA 2008/2): 30 €
- Taksa nga tarifa gjyqësore për nxjerrjen e aktgjykimit (nenet 10.1 dhe 10.21, të UA 2008/2), duke pasur parasysh se vlera e pronës së kërkuar më arsye mund të vlerësohet në 10,000.00 dhe është € 50.00.

Këto tarifa gjyqësore duhet të merren përsipër nga pala ankuese që humb rastin. Në përputhje me nenin 45.1 të Ligjit mbi Shpenzimet Gjyqësore, afati për pagesën e taksave në fjalë është 15 ditë. Neni 47.3 parasheh që në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, pala duhet të paguajë një gjobë prej 50% të shumës së gjobës. Në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, atëherë bëhet zbatimi i detyrueshëm i pagesës.

Këshillë juridike:

Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike.

Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Elka Filcheva-Ermenkova, Gjyqtare, EULEX

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Urs Nufer, Referent i EULEX